

INFORMACION

MBI

PROCEDURAT NË MBËSHTETJE TË ZHVILLIMIT TË AKTIVITETEVE SOCIAL KULTURORE JASHTË AUDITORIT NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Aktivitetet sociale dhe kulturore jashtë auditorëve, luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës universitare dhe në mënyrë të veçantë, i japin mundësi studentëve për ndërveprim shoqëror, zhvillim të aftësive të veçanta drejtuese, për shërbime të ndryshme brenda komunitetit të tyre, argëtim dhe edukim të harmonishëm në shumë plane. Universiteti Politeknik i Tiranës synon të zhvillojë zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët dhe stafin. Për këtë qëllim, fillimisht në projektbuxhetin afatmesëm për tre vitet pasardhëse dhe më tej në buxhetin vjetor, universiteti parashikon rregullisht një fond të veçantë dedikuar plotësisht të nevojave të Këshillit Studentor.

Të gjitha aktivitetet me efekte financiare, përfshirë aktivitetet social - kulturore në Universitetin Politeknik të Tiranës, realizohen në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

-Propozimet e studentëve mbi tipologjinë, kalendarin dhe mënyrën e organizimit të aktiviteteve social kulturore jashtë auditorëve paraqiten me shkrim pranë këshillit studentor të secilës njësi kryesore (Fakultetit).

-Këshilli studentor i njësisë kryesore, miraton ose refuzon propozimet, bazuar në etikën, ndikimin e aktivitetit të propozuar në imazhin e universitetit, impaktit në cilësinë e jetës studentore dhe përputhmërinë me misionin dhe vizionin e zhvillimit institucional.

-Projektet e miratuara renditen sipas prioriteteve dhe i përcillen me shkrim këshillit studentor të UPT. Ky organ, vijon me procedurat standarde që ndiqen për realizimin e të gjithë aktiviteteve me efekte financiare të institucionit.

Procedura standarte që ndiqet për parashikimin, miratimin dhe realizimin e aktiviteteve, është si vijon:

Gjatë muajve qershor – korrik, universiteti përgatit projektbuxhetin afatmesëm për tre vitet pasardhës, bazuar në kërkesat e secilës njësi, përfshi edhe ato të Këshillit Studentor të UPT. Në projektbuxhet, secili zë specifikohet nëse kërkohet nga buxheti i shtetit apo nga të ardhurat e universitetit, në përputhje me klasifikimin ekonomik.

Kërkesat dorëzohen me shkrim pranë administratorit të institucionit. Bazuar në kërkesat dhe nevojat totale të UPT, brenda muajit korrik përfundon përgatitja e projektbuxhetit, i cili më tej miratohet nga organet kolegjiale Senat dhe Bord i Administrimit. Pas miratimit nga Senati dhe Bordi i Administrimit i universitetit, projekt – buxheti dorëzohet pranë MASR.

Në fillim të vitit, në muajin janar, MASR akordon grantin e miratuar nga buxheti i shtetit, për gjatë muajve janar dhe shkurt, secila njësi e UPT, përpilon projektet dhe harton kërkesat bazuar në nevojat e fakultetit, të evidentuara nga secili departament.

E njëjta procedurë ndiqet edhe nga Rektorati për shpenzimet në nivel institucional, si dhe Këshilli Studentor i UPT për nevojat e evidentuara. Projektet dhe kërkesat e secilës njësi hartohen në përputhje me grantin e akorduar nga MASR dhe të ardhurat e veta të UPT.

Buxheti i konsoliduar vjetor, miratohet nga organet kolegjiale Senat dhe Bord i Administrimit. Kërkesat e Këshillit Studentor plotësohen në përputhje me Regjistrin e Prokurimeve, sipas Buxhetit të miratuar, në zbatim të Ligjit dhe rregullave të Prokurimit Publik.

Baza ligjore:

Ligji për zbatimin e Buxhetit në Republikën e Shqipërisë.

Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” .

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Ligji Nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Udhëzimi Nr.8, datë 29.03.2012, “Për Procedurat Standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, i ndryshuar.